



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 799/3 Prot.

Durrës, më 22. 4. 2024

VENDIM

Nr 24, datë 22. 4 2024

**"PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË REGJISTRIN E PARASHIKIMIT TË
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN AKADEMIK 2024"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të UAMD-së të Rregullores së UAMD-së, të shkresës nr. 619/1 prot., datë 26.03.2024 të Administratorit "Kërkesë për një shtesë në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2024", vendimit të Senatit Akademik nr.37, datë 15.04.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtese në Regjistrin e Parashikimit të Procedurave të Prokurimit Publik për vitin kalendarik 2024, sipas relacionit të Administratorit me nr. 619/1 datë 26.03.2024 "Kërkesë për një shtesë në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2024".
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 - Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

